



Affirm[®] 095 SG

Lënda vepruese: Emamectin benzoate
PËRMBAJTJA: Emamectin benzoate: 0,95%
Lëndë ndihmëse: 99,05%
Numri i regjistrimit: AL: 30/18.03.2011
Formulimi: Granula të tretshme në ujë

INSEKTICID SPECIFIK, TRANSLAMINAR, SHUMË EFEKTIV, PËR KONTROLLIN E TENJES SË DOMATES (*Tuta absoluta*) DHE LARVAVE TË LEPIDOPTEREVE. VEPRON NËPËRMJET KONTAKTIT DHE APARATIT TRETËS. PËRDORËT NË PROGRAMET E LUFTËS SË INTEGRUAR (IPM).

PËRDORIMI:

Kulturat bujqësore	Dëmtuesit	Doza	Vërejtje
DOMATE -në fushë të hapur	<i>Tuta absoluta</i>	150 ml/100 l ujë	Sasia e tretësirës spërkatëse varet nga faza e zhvillimit të bimëve, 300 – 1500 l/ha. Numri maksimal i trajtimeve për çdo sezon kultivimi: 3. Interval i trajtimeve: 7 ditë. Të përdoret në programe trajtimesh duke e alternuar me insekticide që kanë mënyra të ndryshme veprimi.
DOMATE -në serra	<i>Tuta absoluta</i>		
PERIME	<i>Tuta absoluta</i> , <i>Heliothis armigera</i> , <i>Spodoptera spp.</i> , <i>Ostrinia nubilalis</i> , <i>Plusia gamma</i> , <i>Pieris brassicae</i> , <i>Plutella xylostella</i> , <i>Depressaria erinaceella</i> etj.		

MËNYRA E PËRDORIMIT: Me spërkatje, gjatë së cilës duhet të sigurohet lagje e mirë e bimëve.

MËNYRA E PËRGATITJES SË TRETËSIRËS SPËRKATËSE: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit duke vazhduar përzierjen dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit.

KOHA E TRAJTIMIT: Me shfaqjen e shenjave të para të infeksionit.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES: 3 ditë.

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme.

PËRZIHET me shumicën e insekticideve, fungicideve dhe rregullatorëve të rritjes.

PERIUDHA E RUAJTJES: 3 vjet. Preparati ruhet në shishe të mbyllura, në vende të thata e të freskëta. Evitoni ruajtjen në temperatura nën -5°C dhe mbi 35°C.

MASAT PARAMBROJTËSE

-Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën. –Mbroni rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit. -Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse. -Pas pune duart dhe fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen. -Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni. –Asgjësoni ambalazhin sipas rregullave në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me lëkurën hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të bollshëm e sapun. Lani rrobat e ndotura para se ti rivishni. -Në rast kontakti të preparatit me sytë i lani ato me ujë të bollshëm për disa minuta. -Në rast se merret me organet e frymëmarrjes nxireni të aksidentuarin në vende të ajrosura. –Në rast gëlltitje mos provokoni të vjella. Çojeni të aksidentuarin në spital dhe i tregoni mjekut etiketën e produktit. Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.
Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



I DËMSHËM PËR ORGANIZMAT UJORE.
Mos ndotni ujrat me preparatin ose
me ambalazhin e tij.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: SYNGENTA Crop Protection AG,
Basel, Switzerland
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax: +41 61 323 12 12